

VENDIM
Nr.984, datë 2.7.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA ALIKO, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publik të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Aliko, të qarkut të Vlorës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 10 (dhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Aliko për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULARË PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Aliko										
Fusha e përdorimit të pronës: kullotë										
Nr.	Nr.i Inv.	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërimit popullor)	Nr.i ngastrës	Destinacioni	Sip.në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	4	Aliko-Mile	Micirepo-Siqja	1	Kullotë	81	Kullotë	MMPAU	DSHP	
2	5	Aliko-Mile	Cimiko-Llaspi	5	Kullotë	105	Kullotë	MMPAU	DSHP	
3	6	Aliko-Mile	Llaspi	6	Kullotë	107	Kullotë	MMPAU	DSHP	
4	7	Aliko-Mile	Gazgane	10	Kullotë	81	Kullotë	MMPAU	DSHP	
5	8	Aliko-Mile	Gropat e Kishës	11	Kullotë	151	Kullotë	MMPAU	DSHP	
6	219	Aliko-Mile	Kodrat e Jermës	2	Kullotë	82	Kullotë	MMPAU	DSHP	
7	220	Aliko-Mile	Balibe (Halo)	3	Kullotë	24	Kullotë	MMPAU	DSHP	
8	221	Aliko-Mile	Balibe (Pllakë)	3	Kullotë	15	Kullotë	MMPAU	DSHP	
9	222	Aliko-Mile	Pllaja Cimiko	4	Kullotë	81	Kullotë	MMPAU	DSHP	
10	223	Aliko-Mile	Shelegart e Pllakës	12	Kullotë	18	Kullotë	MMPAU	DSHP	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-8, 219-223	Pyll, kullotë etj.	Në pronësi